

VENDIMI I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME

TË SHOQËRISË “ÇELA - P” Sh.P.K

Datë 15 Dhjetor 2022

Sot më datë 15 Dhjetor 2022 ora 11:00 u mblodh asambleja e përgjithshme e shoqerisë “Çela - P” sh.p.k me seli në : Lagja “Dyli Haxhire”, Rruga “Kadri Abdiroxha” Zona kadastrale 8526 , Pasuria 3/83 , Tregu i ri i Fruta Perimeve . Elbasan , Shqiperi

Me pjesmarrjen e z. Petrit Çela, zotërues 100% të pjesëve të kapitalit të nënshkruar, , u vendos si më poshte vijon:

Rendi Ditet:

- 1- Analiza e situatës Financiare të Shoqërisë , sipas vendimeve të marra për shtimin e Aktiveve të Qëndrueshme (Ndërtesa) si dhe shtimin e aktivitetit të shoqërisë , referuar blerjes se A.Q.T-së.

Mbledhjen e hapi Administratori i kësaj shoqërie z. Petrit Çela , njëkohësisht dhe Ortak me 100 % të pjesëve në kapitalin fillestare , dhe duke qenë se kurumi i kërkuar nga ligji dhe statuti është arritur , Asambleja është mbledhur në sesion të vlefshëm dhe procedon në marrjen e vendimeve sipas rendit të ditës.

Në lidhje me këtë rend Asambleja e Përgjithshme pas diskutimit ,

VENDOSI

1- Të miratojë marrjen e Limiteve të kredisë në emër të Shoqërisë “Çela-P” sh.p.k ne B.K.T Bank , sipas kushteve te përcaktuara nga Banka , si më poshtë:

- a- Kredi për Investime në vlerën ekuivalente në lekë në shumën 1.400.000 euro (një milion e katërqind mijë EURO) , me një afat maturimi 180 muaj.
 - b- Kredi për investime në vlerën 17.000.000 lekë (shtatëmbëdhjetë milion LEKË) me qëllim blerjen e kredisë dhënë nga ProCredit Bank , me një afat maturimi deri në muajin Gusht të vitit 2024.
 - c- Marrjen e një karte krediti biznesi me limit 500.000 lekë (pesëqind mijë LEKË) , e cila do të jetë në emër të Petrit Çela si Administrator i shoqërisë.
- 1- Si Garanci për Bankën (BKT) në momentin e nënshkrimit të kontratës së huasë do të jenë pasuritë :
 - a- Pasuria e palujtshme Nr 3/196/2 që ndodhet në zonën kadastrale Nr 8526 , në Lagjen “ Dyli Haxhire” në pronësi të shoqërisë “Çela-P ” sh.p.k
 - b- Pasuria e paluajtshme Nr 436/2/8 që ndodhet në zonën kadastrale Nr 2346 , fshati Kusarth , në pronësi të shoqërisë “Çela-P ” sh.p.k

- 2- Të blejë pjesën takuese prej ½ (gjysma) të pasurise së paluajtshme , e llojit Truall + Ndërtesë me Nr 1/66 me siperfaqe totale 2550 m² , nga ku Ndërtesë 2162 m² që ndodhet me adresë , Lagja “ Luigj Gurakuqi ” , Zona kadastrale Nr 8521 e regjistruar me Vol 15 dhe fq 133 në pronësi të shoqërisë “Dushku/E” me Nipt J93112242F
- 3- Për të mbuluar shumën e likujditetave që shoqeria të vazhdojë aktivitetin e saj , të tërheqë nga llogaritë personale të ortakut të vetëm Petrit Çela shumat :
- a- Në Euro 240 000 EUR (dyqind e dyzet mijë EURO),
 - b- Në lekë 8.800.000 (tete milion e tetëqind mijë) lekë

Ngarkohet Administratori i Shoqërisë “Çela-P” sh.p.k , z. Petrit Çela, për depozitimin e këtij Vendimi në QKB , brenda afatit ligjor.

Ortaku i vetëm i Shoqërisë “Çela-P” sh.p.k

/ Petrit Çela /

